



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1313/5 Prot

Tiranë, më 14.09.2023

### VENDIM

**Nr. 40, datë 14.09.2023**

### PËR

### URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

### KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Birn Albania”, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1313 Prot., datë 02.08.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë/Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 06.07.2023, depozituar në adresën elektronike [edrejtaperinformim@tirana.al](mailto:edrejtaperinformim@tirana.al), referuar zbatimit, nga ana e Autoritetit Publik, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.589, datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

- 1. Certifikatat e reja të përdorimit, në përputhje me vendimet e konfiskimit të marra nga Këshilli Kombëtar i Territorit.*
- 2. Sipërfaqen e shtesave pa leje që janë pajisur me këto certifikata të ndara sipas lejes së ndërtimit ose kompanive përfituese.*
- 3. Masat administrative të ndërmarra nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë për kompanitë e kapura në shkelje dhe vendimet përkatëse.*

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 01.08.2023, ka kthyer përgjigje duke cituar se: “... Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë (në vijim, “IMT”), ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, (i ndryshuar), ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2017 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar), VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” (i ndryshuar), VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit”.

Sa më sipër ju informojmë se për të gjitha rastet ndërtimore pa leje të konstatuara gjatë kontrollit në terren, nga IMT, Bashkia Tiranë janë mbajtur të gjitha procedurat ligjore konform legjislacionit në fuqi”.

Me pretendimin se përgjigja e sipërcituar është formale dhe nuk përmban informacionin e kërkuar, ankuesi, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri, me shkresën nr. 1313/1 prot., datë 03.08.2023 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për zotërimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik me e-mail-in datë 10.08.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me shkresën me nr. prot. V-14645/1, datë 07.08.2023, sqaron ndër të tjera se, për sa i përket kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ju bëjmë me dije se, deri më sot, në sistemin elektronik të lejeve nuk ka pasur asnjë aplikim për paisje me çertifikatë përdorimi për objekte të kësaj natyre, për rrjedhojë nuk është miratuar asnjë çertifikatë përdorimi e tillë”.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se: “...përgjigja mbetet e pa plotë, pasi janë kërkuar edhe masat administrative të cilat dihen që janë marrë, për shkak të akteve që janë marrë nga gjykata administrative. Autoriteti Publik duhet të vendosi në dispozicion, gjobat dhe procesverbalet e mbajtura ku përshkruhen këto shkelje.”

Në këto kushte, me e-mail-in datë 14.08.2023, regjistruar me nr. 1312/2 Prot., datë 14.08.2023 ka vijuar me ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikës së tretë të kërkesës për informacion datë 06.07.2023.

Nga ana tjetër, IMT, me shkresën nr. 7439/1 Prot., datë 14.08.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1313/3 Prot., datë 15.08.2023 ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur me e-mail-in datë 01.08.2023, për të cilën ankuesi ka depozituar dhe ankimin.

Ndërkohë, koordinatojta për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 23.08.2023, ka njoftuar ankuesin se vijimi i ankimit ka kaluar edhe njëherë për trajtim pranë strukturës përkatëse dhe në momentin që do të ketë një përgjigje do t'a vendosi atë në dispozicion.

Në vijim, me e-mail-in datë 24.08.2023, koordinatojta për të drejtën e informimit ka përcjellë qëndrimin e IMT-së ku sqarohet se: *“Në vijim të korrespondencës, në lidhje me kërkesën e përsëritur për informacion nga z. Karaj, ju informojmë se për të gjitha rastet e konstatuara ndërtime pa leje, gjatë kontrollit në terren, nga IMT janë mbajtur të gjitha procedurat ligjore konform legjislacionit në fuqi”.*

Pas qëndrimit përfundimtar të Autoritetit Publik, ankuesi me e-mail-in datë 01.09.2023, pretendon se përgjigja që lidhet me pikën e tretë të kërkesës për informacion nuk përmbush kërkesën për të drejtë informimi. Në këto kushte, duke theksuar se ka kërkuar kopje të dokumentacionit përkatës dhe jo bazën ligjore mbi të cilën vepron IMT, ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1313/4 Prot., datë 01.09.2023 duke kërkuar vendosjen në dispozicion të pikës së tretë të kërkesës për informacion, konkretisht: *“3. Masat administrative të ndërmarra nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Tiranë për kompanitë e kapura në shkelje dhe vendimet përkatëse.”*

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se Autoriteti Publik, pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit ka përmbushur detyrimin duke kthyer përgjigje në lidhje me pikat 1 dhe 2 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023, për të cilat nga ana e ankuesit nuk është vijuar me ankim.

Ndërkohë, për sa i përket pikës 3 të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik ka informuar se ka mbajtur të gjitha procedurat ligjore konform legjislacionit në fuqi, por nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e përkatës, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesën për informacion për të cilën është depozituar edhe ankesa.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Tiranë/Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e*

*njohtes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar në pikën 3 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023, përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.*

LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Birn Albania”, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, me nr. 1313 Prot., datë 02.08.2023, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë/Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.*
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikës 3 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023, konkretisht: *(“3. Masat administrative të ndërmarra nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia*

*Tiranë për kompanitë e kapura në shkelje dhe vendimet përkatëse”), duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 21.09.2023.*

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallë së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 14.09.2023.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**